

**UDHËZIM**  
**Nr. 12, datë 26.9.2023**

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË, PËR KRITERET DHE  
PROCEDURAT, PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E  
SUBVENCIONEVE SHTETËRORE, PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË  
SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, PËR VITIN BUXHETOR  
2023**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; germës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të VKM-së nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, si dhe të udhëzimit nr. 9, datë 20.7.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, të ndryshuar; të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023” dhe të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Zbatimin e metodologjisë “Për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2023”, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, bashkitë dhe shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve.
3. Udhëzimi nr. 20, datë 14.10.2022, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2022”, shfuqizohet.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
Belinda Balluku**

**Lidhja 1**

**METODOLOGJI**  
**“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE  
PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHTETËRORE, PËR OFRUESIT E  
SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, PËR VITIN  
2023”**

Kjo metodologji është hartuar në mbështetje të pikës 13, shkronja “dh”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”.

Detajimi i fondit të subvencionit dhe përdorimi i tij për çdo shoqëri rajonale të ujësjellës-kanalizimeve sh.a. të krijuar dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë rajonale, do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahet nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (në vijim AKUM-i) në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit, në përputhje me zërin buxhetor subvencione, me llogari ekonomike (603) dhe të gjithë shtesave të tjera të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Subvencioni i përfituar sipas pikës 1 të kësaj metodologjie, do të përdoret nga AKUM-i, për t'i ofruar ndihmë shoqërive rajonale që janë krijuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, për "Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" (VKM nr. 302/2022), dhe shoqërive që janë në procesin e krijimit të shoqërisë rajonale, nëse këto kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë së re rajonale.

3. Prioritet për përdorimin e fondit nga shoqëritë rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë rajonale, është likuidimi i detyrimeve emergjente të cilat pengojnë veprimtarinë normale të shoqërisë.

4. Subvencioni i përfituar sipas pikës 1 të kësaj metodologjie, zëri subvencione (603), do të përdoret nga AKUM-i, si më poshtë:

a) Për shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen ose kanë krijuar shoqërinë rajonale brenda vitit 2023, sipas VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, të subvencionohen me vlerën nga 30 000 000 lekë secila;

b) Pjesa e mbetur e fondit të subvencionit do të përdoret nga AKUM-i për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike të shoqërive rajonale ujësjellës-kanalizime sipas prioriteteve të mëposhtme:

- Shoqëritë që kanë mbi 75 % të prodhimit me ngritje mekanike;
- Shoqëritë që kanë krijuar detyrime të reja për energjinë gjatë vitit 2023, për shkak të kostove të larta të energjisë.

5. Fondi i dhënë sipas pikës 4, germa "a" të kësaj metodologjie të përdoret nga shoqëritë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për sigurimet shoqërore, pagat, energjinë elektrike dhe shpenzime të domosdoshme për nisjen e operimit të shoqërisë rajonale, bazuar në kërkesat e shoqërive rajonale.

6. Fondi i dhënë sipas pikës 4, germa "b" të kësaj metodologjie të përdoret nga shoqëritë për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike.

7. Vlerësimi i nevojave për fondin e dhënë sipas pikës 4/b, si dhe detajimi dhe shpërndarja nga AKUM-i, do të bazohet në të dhënat e raportuara nga shoqëritë rajonale pranë AKUM-it, në përputhje me kërkesat, formatin dhe afatet e përcaktuara.

8. AKUM-i vlerëson dokumentacionin/të dhënat e paraqitur/a dhe bën shpërndarjen e subvencionit, për shoqëritë rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë rajonale.

9. AKUM-i llogarit vlerën e subvencionit që do të përfitojë secila shoqëri rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë rajonale dhe njofton shoqëritë.

10. AKUM-i, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve", neni 13, shkronja "ë", ka të drejtë të ushtrojë kontrolle, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për çdo shoqëri, që ka përfituar nga fondi i subvencionimit.